

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në mbështetje të Nenit 10, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1, Nenit 12 paragrafit 3, nën-paragrafit 3.1 dhe Nenit 24 paragrafit 5 të Ligjit nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (Gazeta Zyrtare nr.1, 17 janar 2022), Kuvendi i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës miraton:

RREGULLORE PËR PËRPILIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E REGJISTRAVE TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS KOSOVËS

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i regjistrave të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Oda), përmbajtjes së tyre, mënyrës së regjistrimit të të dhënave dhe mirëmbajtjes së tyre.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për Odën, organet e saj dhe zyrtarët e punësuar apo kontraktuar nga Oda.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji në fuqi).
2. Emrat në njërin gjini të përdorura në këtë Rregullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë tjetër, pa diskriminim.

KAPITULLI II REGJISTRAT, PËRMBAJTJA, MËNYRA E REGJISTRIMIT TË TË DHËNAVE DHE MIRËMBAJTJA E TYRE

Neni 4

Llojet e regjistrave

1. Oda në pajtim me Ligjin në fuqi mban këta regjistra:
 - 1.1. Regjistrin e të gjithë anëtarëve të Odës;
 - 1.2. Regjistrin e licencave të lëshuara;
 - 1.3. Regjistrin e anëtarëve të Odës ndaj të cilëve janë shqiptuar masat disiplinore;
 - 1.4. Regjistrin e inxhinierëve të cilëve i është anuluar licenca;
 - 1.5. Regjistrin e inxhinierëve të huaj që veprojnë në Kosovë;
 - 1.6. Regjistrin e edukimit të vazhdueshëm profesional të inxhinierëve të licencuar;
 - 1.7. Regjistrin e sigurimit të përgjegjësisë profesionale të inxhinierëve të licencuar, dhe
 - 1.8. Regjistrin e praktikantëve të Odës.
2. Regjistra tjerë mund të krijohen me propozim të Drejtorit Ekzekutiv të Odës dhe me miratim të Bordit Drejtues të Odës.

Neni 5

Forma e regjistrave dhe publikimi i tyre

1. Regjistrat e Odës nga Neni 4 dhe të dhënat përkatëse mbahen në formë elektronike, të cilat ruhen në formë të përhershme.
2. Mbajtja e regjistrave, mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nga Odës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Të gjithë regjistrat e paraparë me Nenin 4 publikohen dhe azhurnohen rregullisht në ueb-faqen zyrtare të Odës.

Neni 6

Regjistri i të gjithë anëtarëve të Odës

1. Regjistri i të gjithë anëtarëve të Odës përmban të dhënat në vijim:
 - 1.1. Emrin dhe mbiemrin e inxhinierit të licencuar që është anëtar i Odës;
 - 1.2. Adresën e veprimtarisë;
 - 1.3. Numrin kontaktues të telefonit, dhe

- 1.4. E-mail adresën.
2. Regjistri nga paragrafi 1 përmban gjithashtu të dhënat për anëtarët jo të rregullt të Odës, në përputhje me Statutin dhe Ligjin në fuqi.

Neni 7

Regjistri i licencave të lëshuara

1. Regjistri i licencave të lëshuara përmban të dhënat në vijim:
 - 1.1. Emrin dhe mbiemrin e inxhinierit të licencuar;
 - 1.2. Numrin e licencës;
 - 1.3. Kategorinë e licencës;
 - 1.4. Titullin akademik, dhe
 - 1.5. Periudhën e vlefshmërisë së licencës.

Neni 8

Regjistri i anëtarëve të Odës ndaj të cilëve janë shqiptuar masa disiplinore

Regjistri i anëtarëve të Odës ndaj të cilëve janë shqiptuar masa disiplinore të pezullimit të licencës, përmban emrin dhe mbiemrin e inxhinierit të licencuar të cilit ose cilës i është shqiptuar masa disiplinore e pezullimit të licencës, numrin e licencës, arsyen e pezullimit dhe të dhënat tjera përkatëse.

Neni 9

Regjistri i inxhinierëve të cilëve i është anuluar licenca

1. Regjistri i inxhinierëve të cilëve i është anuluar licenca përmban të dhënat në vijim:
 - 1.1. Emrin dhe mbiemrin e inxhinierit të cilit i është anuluar licenca;
 - 1.2. Numri i licencës së anuluar, dhe
 - 1.3. Arsyeja e anulimit të licencës në përputhje me Ligjin në fuqi.

Neni 10

Regjistri i inxhinierëve të huaj që veprojnë në Kosovë

1. Regjistri i inxhinierëve të huaj që veprojnë në Kosovë përbëhet nga dy regjistra:
 - 1.1. Regjistri i inxhinierëve që ushtrojnë veprimtarinë profesionale në mënyrë të vazhdueshme në Kosovë, dhe
 - 1.2. Regjistri i inxhinierëve që ushtrojnë veprimtarinë profesionale në mënyrë të përkohshme ose sipas rastit në Kosovë.
2. Regjistrat nga paragrafi 1 përmbajnë të dhënat përkatëse si në vijim:
 - 2.1. Emri dhe mbiemri i inxhinierit që i njihet licenca e inxhinierit e lëshuar jashtë Republikës së Kosovës;
 - 2.2. Shtetësia e inxhinierit;
 - 2.3. Shteti që ka lëshuar licencën jashtë Republikës së Kosovës;
 - 2.4. Numri i vendimit të Odës për njohjen e licencës;
 - 2.5. Kategoria e licencës;
 - 2.6. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së licencës, dhe
 - 2.7. Mënyra e ushtrimit të veprimtarisë të inxhinierit;
 - 2.7.1. e vazhdueshme apo
 - 2.7.2. e përkohshme ose sipas rastit.

Neni 11

Regjistri i edukimit të vazhdueshëm profesional

1. Regjistri i edukimit të vazhdueshëm profesional përmban të dhënat në vijim:
 - 1.1. Emrin dhe mbiemrin e inxhinierit të licencuar që obligohet të ndjek edukimin e vazhdueshëm profesional në kuadër të Programit një (1) vjeçar;
 - 1.2. Aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional që inxhinieri ka ndjekur;
 - 1.3. Pikët kredituese të fituara;
 - 1.4. Evidencën për inxhinierin që nuk ka përmbushur pikët kredituese obligative sipas Rregullores përkatëse, dhe

1.5. Evidencën për inxhinierin që ka qenë në pamundësi për të ndjekur edukimin e vazhdueshëm profesional sipas Rregullores përkatëse.

Neni 12

Regjistri i sigurimit të përgjegjësisë profesionale

1. Regjistri i sigurimit të përgjegjësisë profesionale të inxhinierëve të licencuar përmban të dhënat në vijim:

- 1.1. Emrin dhe mbiemrin e inxhinierit të licencuar;
- 1.2. Numrin e licencës, dhe
- 1.3. Evidencën për sigurimin e përgjegjësisë profesionale.

Neni 13

Regjistri i praktikantëve të inxhinierisë

1. Regjistri i praktikantëve të inxhinierisë përmban të dhënat në vijim:

- 1.1. Emrin dhe mbiemrin e praktikantit të inxhinierisë të regjistruar;
- 1.2. Numrin e vendimit të Odës për regjistrimin e praktikantit;
- 1.3. Kualifikimin përkatës akademik të praktikantit të inxhinierisë;
- 1.4. Periudhën e regjistrimit të punës praktike, dhe
- 1.5. Emrin, mbiemrin dhe numrin e licencës të inxhinierit që mbikëqyr punën praktike të praktikantit të inxhinierisë.

Neni 14

Regjistrimi i të dhënave dhe mirëmbajtja e regjistrave

- 1. Të dhënat në regjister vendosen në formë elektronike nga Administrata e Odës.
- 2. Çdo e dhënë e vendosur në regjister lidhet drejtpërdrejtë në formë elektronike, për përdorim të brendshëm, me dokumentet dhe dosjet përkatëse të Odës dhe organeve ose njësisë së saj.
- 3. Të dhënat e vendosura nuk mund të fshihen nga regjistri, pa u evidentuar në regjister një gjë e tillë.

4. Regjistrat e Odës mirëmbahen nga Administrata e Odës. Për këtë qëllim Oda mund të kontraktoj edhe shërbime të jashtme.

Neni 15

Njoftimi i ndryshimit të të dhënave në regjistrë

1. Të gjithë inxhinierët njoftojnë Odën për çfarëdo ndryshimi në të dhënat e përfshira në Regjistrë, për të cilat organet apo Administrata e Odës nuk kanë informacion.
2. Njoftimi nga paragrafi 1 bëhet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë.
3. Dështimi për të njoftuar Odën për ndryshimin e të dhënave sipas këtij Neni përbën shkelje disiplinore.

Neni 16

Vërtetimi për të dhënat në regjistrë

Me kërkesë të inxhinierit, Drejtori Ekzekutiv lëshon vërtetim të veçantë për evidentimin e statusit apo të dhënave tjera të inxhinierit sipas regjistrave të kësaj Rregulloreje.

Neni 17

Siguria e të dhënave

Drejtori Ekzekutiv dhe Administrata e Odës ndërmarrin të gjitha veprimet për të siguruar të dhënat e regjistrave nga çfarëdo sulmi kibernetik, prishje apo rrethanë tjetër që mund të dëmtoj apo shkatërroj regjistrat ose të dhënat e caktuara.

Neni 18

Qasja në regjistra

Qasje për të ndërhyrë në regjistrat elektronik të Odës kanë vetëm personat dhe zyrtarët kompetent të Odës.

KAPITULLI III

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 19

Menaxhimi i përkohshëm i regjistrave

Komisioni Ministror për Themelimin të Odës menaxhon regjistrat e Odës deri në miratimin e Rregullores për organizim të brendshëm të Odës dhe funksionalizimin e Administratës së Odës.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga Kuvendi i Odës dhe publikohet në faqen elektronike të Odës.

Arsim Rapuca



Kryetar i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës